



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial**
- * **Trajnimi i Trajnuesve**

Korrik 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Akademia e Drejtësisë e Kosovës i bashkohet Kampionëve të Barazisë Gjinore në Rrjetin Gjyqësor



Akademia e Drejtësisë e Kosovës iu bashkua iniciativës për futjen e Kampionëve të Barazisë Gjinore në Rrjetin Gjyqësor. Kjo iniciativë ka nisur në fillim të muajit prill gjatë Forumit Gjyqësor për Barazinë Gjinore në Budva, ku pjesëmarrësit theksuan nevojën për një qasje të koordinuar në trajnimin e profesionistëve gjyqësorë në lidhje me këtë aspekt në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

“Promovimi i barazisë gjinore është synim i rëndësishëm në të gjitha vendet e Evropës. Megjithatë, ka disa faktorë shoqërorë në Ballkanin Perëndimor që e bëjnë këtë çështje veçanërisht me rëndësi për rajonin. Dhuna e përhapur kundër grave, ekzistimi i stereotipeve gjinore, nën-përfaqësimi i grave në politikë dhe në poste të larta, si dhe impakti i COVID-19 tek gratë posaçërisht të cënueshme janë vetëm disa nga faktorët që tregojnë se përmirësimi i pozitës së grave në rajon është çështje urgjente. Gratë janë të barabarta në ligj por jo në praktikë. Zbatimi i ligjit dhe masave për arritjen e barazisë gjinore mbetet sfidë serioze, dhe gjykatat vendase si dhe ekspertët ligjorë në krejt rajonin kanë një rol jetik në trajtimin e kësaj sfide,” tha Biljana Braithewaite, Drejtoreshë e Programit të Qendrës AIRE për Ballkanin Perëndimor.

Me nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale, Qendra AIRE ka nisur bashkëpunimin me institucionet e trajnimit gjyqësor në Mal të Zi, Serbi, Maqedoni të Veriut, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë, duke vendosur kësh-tu themelet për veprimtarinë e Rrjetit. Jetësimi i kësaj iniciative është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

“Akademia e Drejtësisë e Kosovës ka kënaqësinë të jetë pjesë e përpjekjeve të Kampionëve të Barazisë Gjinore në Rrjetin Gjyqësor, gjë që do të realizohet sot me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit të firmosur nga akademitë gjyqësore dhe qendrat e trajnimit të rajonit. Duke njohur rëndësinë e trajnimeve për barazinë gjinore, që nga viti 2017 e më tej ka nisur zbatimin e trajnimeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit. Akademia e Drejtësisë e Kosovës që nga viti 2017, në partneritet me organizata profesioniste ndërkombëtare dhe donatorë, ka ofruar trajnime mbi barazinë gjinore për gjyqtarët, prokurorët, profesionistët e drejtësisë, dhe ushtruesit e lirë të profesioneve ligjore. Trajnimet kanë mbuluar pjesë të së drejtës substanciale dhe procedurale në aspekte si pasuria, punësimi, trashëgimia, qeverisja etj.,” tha Drejtori i Akademisë Enver Fejzullahu.

Znj. Braithewaite i uroi mirëseardhjen Akademisë së Drejtësisë, duke çmuar përkushtimin e saj dhe duke theksuar se Qendra AIRE do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e saj për të fuqizuar programet e trajnimit gjyqësor.

Ajo nënvizoi se ekzistenca e Rrjetit do të vendosë themelet e bashkëpunimit mes qendrave të trajnimit gjyqësor kudo në rajon. “Rrjeti do të ofrojë mundësi për fuqizimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe ushtruesve të profesionit të drejtësisë, do të ofrojë trajnime specifike me impakt praktik, si dhe hulumtime të

thella dhe ndarje të njohurive, shkathtësive, përvojave dhe ideve në lidhje me barazinë gjinore, sipas një modeli të rrjetëzimit dhe mentorimit të strukturuar,” permbylli znj. Braithwait.



Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe KGJK-së

Më 15 korrik 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu dhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për përmbushjen e përgjegjësisive që dalin nga Strategjia për Sundim të Ligjit ndërmjet dy institucioneve.

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktoj kushtet, fushëveprimin e punës dhe përgjegjësitë e palëve: në sferën e hartimit të programeve të trajnimit për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës të gjyqtarëve, për trajnimin e anëtarëve të komisioneve për rekrutimin e gjyqtarëve, trajnimet e detyrueshme që dalin si rezultat i mangësisë gjatë vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, trajnimet e zyrtarëve të Njësisë së verifikimit të KGJK-së, përkthyesve-intepretëve të gjykatave, për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve dhe garantimin e mekanizmave për koordinim në trajnimin e gjyqtarëve si dhe ndërlidhjen e data-bazave, shkëmbimin e informatave në mes KGJK-së dhe

AD.

Drejtori Ekzekutiv i AD-së, ka thënë se institucioni që udhëheq ai do të angazhohet për të bërë zbatimin e trajnimeve për sistemin gjyqësor, në mënyrë që të bëhet ngritja e nevojshme e kapaciteteve të sistemit gjyqësor.

Nga ana tjetër, Kryesuesi Zogaj, ka thënë me këtë rast se ky memorandum do të fokusohet në shkëmbimin e informatave të ndërsjella për zbatimin e aktiviteteve për vlerësimin e nevojave, përcaktimin e politikave, zbatimin e programit dhe shkëmbimin e të dhënave lidhur me trajnimet.

Këshilli Gjyqësor dhe Akademia e Drejtësisë do të bëjnë në vazhdimësi shkëmbimin e informatave lidhur me të dhënat për pjesëmarrjen në trajnime dhe programe të tjera.



Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe KPK-së

Më 25 korrik 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për përmbushjen e përgjegjësiqe që dalin nga Strategjia për Sundim të Ligjit ndërmjet dy institucioneve respektive.



Qëllimi i këtij Memorandumi është vendosja e bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës për bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve me qëllim të realizimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026 përmes të zbatimit të aktivite-

teve të parapara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie në fushën e trajnimit.

Drejtori Ekzekutiv i AD-së, ka thënë se institucioni që udhëheq ai do të angazhohet për të bërë zbatimin e trajnimeve për sistemin prokurorial, duke ofruar mbështetje profesionale, teknike dhe organizative, në mënyrë që të bëhet ngritja e nevojshme e kapaciteteve të sistemit prokurorial.

Nga ana tjetër, Kryesuesi Maloku, ka thënë me këtë rast se ky memorandum do të fokusohet në përcaktimin dhe garantimin e standardeve të koordinimit dhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike për të mundësuar shkëmbimin e informatave në mes të AD-së dhe KPK-së në trajnimin e prokurorëve.

Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Prokurorial do të bëjnë në vazhdimësi shkëmbimin e informatave lidhur me të dhënat për pjesëmarrjen në trajnime dhe aktiviteteve tjera të përbashkëta.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Fillimi Zyrtar i Programit të Trajnimit Fillestar për Prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së IX

Më 04 korrik 2022, Akademia e Drejtësisë, zyrtarisht ka filluar Programin e Trajnimit Fillestar, për prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së IX, duke realizuar takimin e parë me prokurorët e sapoemëruar.



Hapjen e këtij takimi e bëri Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu duke i uruar prokurorët e ri për emërimin e tyre dhe fillim të mbarë në rrugëtimin e detyrës së re, për të vazhduar më pas me njoftimin e rolit dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për ngritjen e shkathhtësive profesionale dhe praktike me qëllim të përgatitjes së tyre adekuate për të ushtruar funksionin e prokurorit. Po ashtu z. Fejzullahu, në pika të shkurta elaboroi strukturën e programit fillestar, mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij, si të pjesës teorike, po ashtu edhe atë praktike, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë program. Më tej ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të Akademisë së

Drejtësisë, për mbështetje të vazhdueshme për prokurorët e sapoemëruar, me qëllim që trajnimi fillestar të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Prokurorëve të sapo emëruar iu drejtua edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, i cili potencoi mbështetjen e KPK-së në drejtim të prokurorëve të sapoemëruar, dhe duke e theksuar rolin dhe rëndësinë që e kanë prokurorët lidhur me sfidat të cilat do të presin gjatë ushtrimit të detyrës.

Në përfundim të takimit njoftues ku shënon fillimin zyrtar të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, Udhëheqësja e Programit të Trajnimeve Fillestare znj. Valmira Pefqeli me informata të detajuara i njoftoi rreth programit, për mënyrën e realizimit të trajnimit teorik i dhe atij praktik i cili do të realizohet në prokuroritë përkatëse ku janë të emëruar prokurorët si dhe vizitat që do të realizohen në institucione jo gjyqësore. Po ashtu theksoji edhe rëndësinë e vlerësimit, gjë që ka shumë rëndësi në performancën e prokurorëve në trajnimin fillestar.

Trajnimin fillestar do ta ndjekin 6 prokurorë të sapoemëruar gjenerata e nëntë (9) (2022/2023).



Takimi me mentorët e prokurorëve të sapo emëruar -gjenerata e IX

Më 04 korrik 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, priti në takim mentorët e prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së IX.



Qëllimi i takimit ishte njoftimi i mentorëve me programin trajnues fillestar të cilit do t'i nënshtrohen prokurorët e sapo emëruar, aktivitetet dhe angazhimet e tyre gjatë mentorimit, ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë, dhe vlerësimi përfundimtar. Gjithashtu u ritheksuar se përkushtimi dhe përgjegjësia për zbatimin e kësaj faze në trajnim duhet të jetë e lartë nga ana

e mentorëve. Po ashtu prokurorët të caktuar për mentor u informuan në detaje rreth organizimit të trajnimit praktik, ku kjo pjese e trajnimit realizohet në prokuroritë përkatëse ku janë caktuar prokurorët e sapo emëruar.

Në gjeneratën e IX të prokurorëve të sapo emëruar janë caktuar 6 mentorë/prokurorë, të caktuar për mbështetjen e trajnimit praktik i cili do të realizohet në prokurorit themelore përkatëse dhe do të zgjatë për periudhë një (1) vjeçare 2022/2023.

Fillimi zyrtar i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e IX)



Më 15 korrik 2022, Akademia e Drejtësisë, zyrtarisht ka filluar Programin e Trajnimit Fillestar, për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX, duke realizuar takimin e parë me gjyqtarët e sapo emëruar.

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu fillimisht i uroi gjyqtarët për emërimin e tyre dhe rrugëtimin e detyrës së re, për të vazhduar tutje me njoftimin e rolit dhe rëndësisë që ka trajnimi fillestar, për përgatitjen e tyre të mëtejme profesionale dhe avancimin e njohurive. Gjyqtarët e sapo emëruar u njoftuan rreth strukturës së trajnimit dhe metodologjisë së realizimit të trajnimit. z. Fejzullahu potencoi me theks të veçantë për mbështetje të vazhdueshme gjatë rrugëtimin njëvjeçarë për gjyqtarët e sapo emëruar me qëllim që trajnimi fillestar të jetë i plotësuar dhe fitimprurës për gjyqtarët e rinj.

Duke e falënderuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për prezencën e tij në këtë takim Kryesuesit Zogaj, edhe një herë i uroi gjyqtarët për pozitën e re duke ju dëshiroj punë të suksesshme por gjithashtu duke përmendur sfidat që do i presin. Po ashtu z. Zogaj shprehu mbështetjen e KGJK-së dhe Akademisë si dhe i inkurajoi gjyqtarët e sapo emëruar për një përkushtim dhe angazhim maksimal me qëllim të përgatitjes së tyre adekuate që të ushtrojnë në

mënyrë të drejtë dhe profesionale funksionin e gjyqtarit.

Gjyqtarëve të sapo emëruara me një fjalë rasti ju drejtua edhe z. Vilard Bytyqi, Kryetar i Komisionit për Trajnime duke ju uruar detyrën e re dhe dëshiruar sukses, theksoj që duhet të jeni krenar për detyrën, të gjithë ju që jeni produkt një procesi me integritet dhe meritore që ka qenë shembulli ma i mirë i dhënë nga një institucion që administron me një pushtet të pavarur si KGJK.

Së fundmi gjyqtarëve të sapo emëruar, iu drejtua edhe Udhëheqësja e Programit të Trajnimeve Fillestare znj. Valmira Pefqeli me informata të detajuara i njoftoi rreth programit, për mënyrën e realizimit të trajnimit teorik dhe praktik i cili do të realizohet në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar si dhe vizitat që do të realizohen në institucione jo gjyqësore në bazë të kompetencës së Programit Fillestar. Po ashtu theksoji edhe rëndësinë e vlerësimit gjatë në performancën e gjyqtarëve.

Gjyqtarët e sapoemëruar, janë pajisur me dokumente që hynë në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar si dhe Kalendari trajnues për muajin korrik 2022.

Trajnimit fillestar (2022/2023) do ta ndjekin 48 gjyqtarë të sapo emëruar ku prej tyre 3 janë të komunitetit serb. Gjyqtarët janë të emëruar në 6 degë të nivelit themelorë dhe të gjitha nëndegët e gjykatave të Kosovës, në këtë gjeneratë gjyqtarët do ta realizojnë trajnimin të ndarë në dy grupe, ku njëri grup do të filloj trajnimin me lëmine penale për të vazhduar me atë civile ndërsa grupi tjetër me lëmine civile për të vazhduar me atë penale.

Trajnimet fillestare për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata (IX) për muajin korrik 2022

Trajnimet fillestare për 6 prokurorët e sapo emëruar janë realizuar konform programit trajnues dhe kalendarit të përcaktuar për muajin korrik. Prokurorët për çdo javë dy ditë kanë ndjekur sesionet e trajnimit teorik, ndërkaq tre ditë tjera sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse.

Gjatë këtij muaji janë realizuar 10 sesione të trajnimit teorik dhe 13 ditë të trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse. Sesionet e trajnimit teorik janë realizuar nga modulet: Shkathtësitë personale dhe ndër personale dhe Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale, janë realizuar tri (3) sesione nga nën moduli “Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve me theks te Individit dhe mjedisi social, Motivi, Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit dhe Mbrojtja e shëndetit dhe Përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës.

1 (një) sesion trajnimi është realizuar nga nën moduli “Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i

performancës” ku prokurorët përfituan nga rëndësia dhe parimet e menaxhimit të rrjedhës së lëndës. Po ashtu dy (2) sesione për “Rregullat e komunikimit” me theks te bazat dhe llojet e komunikimit masiv.

Në kuadër të modulit Rendi Juridik Kombëtar dhe ndërkombëtarë, janë realizuar 4 (katër) sesione trajnuese nga nën moduli “Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”. Prokurorët nga këto sesione përfituan njohuri për burimet e së drejtës kushtetuese dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe organizmin e Sistemit gjyqësor dhe Prokurorial në Republikën e Kosovës.

Metodologjia e trajnimit është zbatuar duke trajtuar raste praktike si dhe përmes diskutimeve interaktive.



Trajnimet fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata (IX)

Trajnimet fillestare për 48 gjyqtarët e sapo emëruar janë realizuar konform kalendarit të përcaktuar për muajin korrik. Programi është dizajnuar që të zbatohet fillimisht me sesionet e trajnimit teorik në pesë ditë të javës. Po ashtu trajnimet janë realizuar duke ndarë gjyqtarët në dy grupe meqenëse numri prej 48 personave në një sallë është vlerësuar se nuk do të ofronte komoditet dhe njëkohësisht cilësi dhe efekt të trajnimit.

Për shkak edhe të koordinimit të trajnuesve, grupi i parë i gjyqtarëve ka filluar me modulet trajnuese: Kodi Penal-pjesa e përgjithshme, Rendi Juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë si dhe me Shkathtësitë personale dhe ndër personale që kanë rezultuar me gjithësejt 20 sesione trajnuese.

Nga moduli: Kodi Penal-pjesa e përgjithshme janë realizuar gjithsej 10 (dhjetë) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar nocioni dhe elementet e veprës penale, vepra penale dhe përgjegjësia penale, mbrojtja e nevojshme, dhuna dhe kanosja, dashja, pakujdesia, lajthimi, bashkëkryerja e veprës penale, shtytja dhe marrëveshja për të kryer vepër penale.

Nga Kodi Penal-pjesa e veçantë” janë realizuar 2 (dy) sesione me ç ‘rast janë shtjelluar: veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në kuadër të modulit Rendi Juridik Kombëtar dhe ndërkombëtarë, janë realizuar 4 (katër) sesione trajnuese nga “Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”. Gjyqtarët nga këto sesione përfituan njohuri për burimet e së drejtës kushtetuese dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe organizmin e Sistemit gjyqësor dhe Prokurorial në Republikën e Kosovës.

Nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale janë realizuar 4 (katër) sesione, trajnuese për “Etikën profesionale dhe përgjegjësinë disiplinore” me theks te Kodi i etikës profesionale për gjyqtarë, parimet e kodit të etikës për gjyqtarë, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe procedura disiplinore për gjyqtarët.

Grupi i dytë i gjyqtarëve të sapo të sapo emëruar ka filluar me modulet trajnuese: Shkathtësitë personale dhe ndër personale, Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese dhe E drejta civile, administrative dhe ekonomike që kanë rezultuar me gjithësejt 20 sesione trajnuese.

Nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale janë realizuar 4 (katër) sesione, trajnuese nga nën moduli “Etika profesionale dhe përgjegjësia disiplinore” me theks te Kodi i etikës profesionale për gjyqtarë, parimet e kodit të etikës për gjyqtarë, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe procedura disiplinore për gjyqtarët.

Po ashtu dy (2) sesione për “Rregullat e komunikimit” me theks tek bazat dhe llojet e komunikimit masiv.

Në kuadër të modulit Rendi Juridik Kombëtar dhe ndërkombëtarë, janë realizuar 4 (katër) sesione trajnuese nga “Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”. Gjyqtarët nga këto sesione përfituan njohuri për burimet e së drejtës kushtetuese dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe organizmin e Sistemit gjyqësor dhe Prokurorial në Republikën e Kosovës.

Nga moduli Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese janë realizuar dy (2) sesione për “Ligjin për kundërvajtje” me theks te veprat e kundërvajtjes, procedura dhe aktgjykimi i kundërvajtjes si dhe organet e paraqitjes së kërkesës për procedurën e kundërvajtjes.

Nga moduli: E drejta civile, administrative dhe ekonomike” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese me theks te e drejta civile, nocioni, parimet dhe burimet e së drejtës civile, marrëdhëniet juridiko-civile dhe klasifikimi i të drejtave subjektive civile, punët juridike, modifikimi i tyre dhe ndarja e punëve juridike dhe përfaqësimi si dhe pavlefshmëria e punëve juridike.

Po ashtu janë realizuar edhe katër (4) sesione trajnimi për “Procedurën përmbaremore” me ç

‘rast janë trajtuar: fillimi i procedurës së përmbaremit, kompetenca dhe vendimet e organit përmbareues, bazat juridike për caktimin e përmbaremit, mjetet, objekti dhe zbatimi i përmbaremit dhe mjetet juridike në procedurën përmbaremore, kthimi i punëtorit në punë dhe procedura e marrjes dhe dorëzimit të fëmiut.

Metodologjia e trajnimit për dy grupet është realizuar me anë të metodës së bashkëbisedimit si dhe me anë të rasteve praktike.

Nga 48 gjyqtarë të sapa emëruar, gjenerata e (XI), 3 prej tyre janë nga komuniteti serb.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë

Më 05 Korrik 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të rrisin kapacitetet e tyre në zbatimin praktik të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë konform standardeve më të larta në mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Trajnimi si fillim u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të procedurës gjyqësore dhe dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet ligjore-bazat për caktimin e masave për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë, të drejtat e pandehurit në procedurën gjyqësore, paraburgimi dhe arsyetimi i aktvendimit për caktimin për paraburgim, paraburgimi dhe masat tjera në raport me të drejtat

dhe liritë e njeriut.

Me rastin e këtij trajnimi u vu në pah që instrumentet ndërkombëtare por edhe legjislacioni ynë sugjeron që paraburgimi të aplikohet vetëm kur shteren të gjitha mundësitë tjera për ta arritur qëllimin. Gjithashtu pjesëmarrësit përmes diskutimit të rasteve praktike patën mundësinë e diskutimit të problemeve dhe efektin e tyre në procedurën gjyqësore me rastin e mos zbatimit apo të zbatimit jo të drejtë të dispozitave ligjore që i parashehë ligj për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 10 gjyqtarë dhe 6 prokurorë nga niveli themelor i gjykatave dhe prokurorive nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Tryezë për çështje pronësore



Më 06-07 Korrik 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar “Tryezën për çështje pronësore”.

Qëllimi kryesor i tryezës ishte adresimi i sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në fushën e të drejtës pronësore, ku janë trajtuar çështjet thelbësore në kuadër të së drejtës pronësore.

Në ditën e parë të tryezës u trajtuan çështjet lidhur me: E drejta e pronësisë; Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët; Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë - Fitimi derivativ dhe origjinere e fitimit të drejtës së pronësisë si dhe Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë.

U theksua se pronësia e përbashkët mund të krijohet përmes ligjit ose përmes kontratës. Marrëveshja me të cilën krijohet pronësia e përbashkët mund të lidhet vetëm nëse shprehimisht është e lejuar me ligj. Prandaj, nëse disa persona kanë të drejtë pronësie mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara, atëherë ata janë pronarë të përbashkët. Pronarët e përbashkët mund të kërkojnë shitjen e pjesëshme të pronësisë së përbashkët, por jo në kohë të papërshtatshme.

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan çështjet lidhur me: Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore; Posedimi dhe mbrojtja e posedimit; Pengu, hipoteka, parablerja, barra sendore, dhe e drejta e ndërtimit (Superficies).

Më tutje u potencua se barra sendore mund të caktohet si në favor të një personi të caktuar - barra sendore personale, ose edhe në favor të pronarit përkatës të një paluajtshmërie tjetër, ku për krijimin e barrës sendore është e nevojshme një kontratë në formën e shkruar dhe regjistrimi i

barrës sendore në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Çdo përfitues nga barra sendore mund të kërkojë nga pronari të përmbushë detyrimin për të gjithë përfituesit. Barra sendore në një paluajtshmëri që ekziston në favor të pronarit të një paluajtshmërie tjetër nuk mund të ndahet ose cenohet nga e drejta pronësisë në këtë paluajtshmëri.

Trajtimi i çështjeve në këtë tryezë është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat janë prezantuar përmes rasteve konkrete.

Raste e prezantuara ishin përzgjedhur me kujdes dhe mundësuan trajtimin e të gjitha sfidave që të kanë të bëjnë në lëminë e çështjeve pronësore. Përmes rasteve të përzgjedhura panelistët prezantuan hulumtimet e tyre nga praktika gjyqësore në gjykata ku punojnë dhe shpjeguan se rastet paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Po ashtu prezantimet në tryezë u mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve pronësore, për çka moderatorët ishin të përgatitur dhe ofruan përgjigjet dhe komentet e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e lëmisë që u trajtuan.

Metodologjia e tryezës është zhvilluar në diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e

diskutuar.

Përfitues të kësaj Tryeze ishin 15 gjyqtarë dhe 1 bashkëpunëtorë profesional. Prej gjyqtarëve, 1 prej tyre ishte nga Gjykata Supreme, 3 nga Gjykata e Apelit si dhe 11 gjyqtar nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Veprat penale kundër mjedisit

Me 14 korrik 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme dhe në bashkëpunim me GIZ është realizuar trajnimi me temë: “Veprat penale kundër mjedisit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe interpretimi dhe zbatimi i drejtë i dispozitave përkatëse në praktikën gjyqësore të veprave penale kundër mjedisit.

Trajnimi fillimisht është fokusuar me pjesën teorike të nocioneve të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit, shkatërrimit të botës bimore me materie të dëmshme si dhe shkretërimin e pyjeve. Në vazhdim është fokusuar me përkufizimin dhe elementet esenciale të veprave penale kundër mjedisit, rrethanat, mënyrat dhe format e kryerjes dhe problemet praktike me rastin e kualifikimit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve nga praktika dhe në këtë mënyrë edhe të qartësojnë dispozitat ligjore adekuate. Po ashtu si ilustrim u përdoren edhe disa raste nga praktika e GJEDNJ-së e cila pavarësisht “mungesës” të një rregullimi të përcaktuar shprehimisht për mjedisin i ka dhënë zgjidhje çështjeve përkatëse duke zbatuar në nenet e Konventës që përfshijnë rregullime të përgjithshme lidhur me mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave themelore duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën për të pasur një mjedis të pastër e cila lidhet drejtpërdrejte me të drejtën për të gëzuar jetën private, pronën, familjen etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 4 nga Gjykatat Themelore, 1 prokuror nga Prokuroritë Themelore, 5 inspektor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe 2 zyrtarë policor.

Tryezë për mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës sipas Ligjit të punës

Më 14 Korrik 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar Tryezën me temë “Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte adresimi i sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në kontestet e punës në të cilën janë trajtuar çështjet thelbësore në kuadër të procedurës për mbrojtjen gjyqësore në kontestet e tilla. Panelistë të angazhuar në këtë tryezë iishin: z. Zenel Leku, z. Rustem Thaqi, gjyqtar në Gjykatën Supreme dhe z. Lumni Sallauka, gjyqtar në Gjykatën e Apelit. Tryeza si fillim u orientua në trajtimin dhe shpjegimet sa i përket kontratave të punës dhe llojet e tyre për të vazhduar më tutje me kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit, procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës, respektimi I afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore si dhe zbatimi i marrëveshjes së përgjithshme kolektive dhe sektoriale.

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat janë prezantuar përmes rasteve konkrete.

Në këtë tryezë ndër të tjera janë trajtuar edhe çështjet rreth procedurës së filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t’i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në konteste të tilla.

Metodologjia e tryezës ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive dhe prezantimi i çështjeve përmes rasteve.

Përfitues të kësaj Tryezës ishin 18 gjyqtarë nga divizioni civil, prej tyre 5 nga Gjykata e Apelit dhe 13 nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Tryezë: Veprat penale kundër integritetit seksual

Me 15 korrik 2022 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar tryeza me temë: “Veprat penale kundër integritetit seksual”.

Qëllimi kryesor i tryezës ishte shqyrtimi i çështjeve aktuale që po paraqiten në lidhje veprat penale kundër integritetit seksual dhe eliminimi i dilemave në interpretimin e dispozitave ligjore sa i përket këtyre veprave penale.

Në tryezë u trajtuan çështjet aktuale nga praktika gjyqësore kur kryerësi është i rritur si dhe u analizuan format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera të ngjashme lidhur me integritetin seksual duke elaboruar se cilat janë elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual. Vëmendje e veçantë në këtë tryezë kishin edhe Martesat e hershme dhe Sulmi seksual duke potencuar se ndjeshmëria e

këtyre veprave penale kërkon trajtim më të detajuar për të hequr dilemat nga fakti se dispozitat ligjore lënë vend për interpretim dhe konfuzion.

Në tryezë u theksua se zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët prandaj përmes rasteve nga praktika gjyqësore u analizuan dhe u ofruan zgjidhjet më të mira ligjore në këtë fushë.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 4 gjyqtarë dhe 5 prokurorë kryesisht nga niveli themelor i gjykatave dhe prokurorive si dhe 2 zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

Trajnim për Lirinë e shprehjes dhe të drejtën e qasjes në dokumente publike

Me 05-06 korrik 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti i JUFREX, në kuadër të trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive ka realizuar: “Trajnim për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e qasjes në dokumente publike” dedikuar për zyrtarë për komunikim me publikun nga Gjykatat dhe Prokuroritë si dhe asistentë të kryetarëve të Gjykatave dhe Kryeprokurorëve”.

Qëllimi i trajnimit ishte që zyrtarët për komunikim brenda Gjykatave dhe Prokurorive, si dhe asistentët e kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve, të njihen me konceptet themelore të Konventën Evropiane, përkatësisht rreth lirisë së shprehjes, fushëveprimit të nenit 10 të KEDNJ, dhe funksionimit të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut si dhe të drejtat e qasjes në dokumente publike bazuar në kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

Trajnimi në ditën e parë u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të drejtës së lirisë së shprehjes, bazuar në standardet e Konventës

Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut si dhe zhvillimet sa i përket jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut në këtë fushë.

Në ditën kryesisht për të drejtën e qasjes në dokumente publike me theks te rregullimi kushtetues dhe ligjor në nivel vendor duke u fokusuar edhe te Roli i Agjencisë për Informim dhe Privatësi në të drejtën e informimit etj.si dhe nga perspektiva e Konventës së Këshillit të Evropës për Qasje në Dokumente Publike.

Pjesëmarrësit paten mundësinë e diskutimit për qasjen në dokumente në gjykata dhe prokurori duke pasur për bazë kriteret që përcakton legjislacioni në fuqi dhe natyrisht përmes rasteve studimore dhe punës në grupe të rrisin kapacitetet e tyre në këtë fushë.

Përfitues të trajnimit ishin 26 zyrtarët për informim, zyrtar ligjor dhe asistentë administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë. Prej tyre 12 nga gjykatat dhe 14 nga prokuroritë.



Aktivitetet për trajnues

Punëtori për certifikimin e trajnuesve



Me 05-7 korrik 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës – zyra e OPDAT në Kosovë dhe zyra rajonale e OPDAT në Kroaci, kanë realizuar Punëtorinë tre (3) ditore, për certifikimin e Trajnuesve të AD-së, nga fusha Penale.

Kjo nismë, e quajtur Programi i Trajnimit të Trajnerëve (Programi ToT), është krijuar duke pasur parasysh nevojën për plotësimin e përpjekjeve të AD-së për të forcuar programet e edukimit dhe trajnimit. Gjithashtu për të rrit kapacitetet në hartimin, zhvillimin dhe dhënien e prezantimeve efektive për gjyqtarët dhe prokurorët.

Për tri ditë me radhë, pjesëmarrësit patën mundësinë të marrin udhëzime për hartimin e trajnimeve interaktive, mënyrën e prezantimeve duke përfshirë audiencën dhe nevojat e trajnimit, për zhvillimin e materialeve dhe

ekstrakteve të dobishme që i kontribuojnë organizimit dhe mbajtjes së punëtorive, trajnimeve dhe të vlerësojnë kënaqshmërinë e pjesëmarrësve dhe zbatimin e njohurive dhe aftësive.

Theks i veçantë gjatë kësaj punëtorie i është kushtuar rritjes së aftësive prezantuese të pjesëmarrësve, pavarësisht nga niveli i përvojës duke iu mundësuar demonstrimin e prezantimit bazuar në këshillat dhe rekomandimet sa i përket kohës, materialeve, angazhimit të audiencës, marrjes së reagimeve dhe çështje tjera me rëndësi që duhet pasur kur planifikohet një punëtori, seminar ose konferencë.

Kursi i certifikimit është organizuar në pajtim me kërkesat e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, për certifikimin e trajnuesve të saj.

Trajnues të kësaj punëtorie ishin 2 ekspertët ndërkombëtar: Ameet Kabrawala - Këshilltar Rezident Ligjor në Zyrën e OPDAT në Kroaci si dhe Jelena Firic - Këshilltare ligjore, zyra e OPDAT në Ambasadën e SHBA në Kroaci.

Përfitues dhe pjesëmarrës në punëtori ishin 7 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 4 trajnuesit tjerë të jashtëm të cilët shërbejnë si trajnues në Akademinë e Drejtësisë në fushën Penale.



Trajnimi i trajnuesve për ndërmjetësimin-sesioni II

Nga data 14 korrik e deri më 17 korrik, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, ka zhvilluar sesionin e dytë të Trajnimit të Trajnuesve për Ndërmjetësim.

Trajnimi ishte vazhdimësi e sesionit të I-rë të zhvilluar në Maj, të cilin janë duke e vijuar 15 ndërmjetësues nga regjione të ndryshme të Republikës së Kosovës, me të cilët synohet të krijohet një kuadër i profesionalizuar i trajnuesve nga fusha e Ndërmjetësimit.

Sesioni i II-të i trajnimit ishte i fokusuar në çështjet Pronësore, Familjare dhe Komerciale, me ç'rast i gjithë trajnimi ishte i kombinuar me raste praktike, dhe me role simuluese nga të

gjithë pjesëmarrësit, duke u ndarë në grupe punuese.



Përveç ekspertëve nga SHBA, z. Peter Swandon dhe znj. Emily Rife, trajnimi u begatua edhe nga ekspertja nga Sllovenia znj. Simona Frumen, e cila shpalosi njohuritë e saj në çështjet e Ndërmjetësimit nga fusha Civile/ Pronësore, Komerciale dhe Familjare.

Gjithashtu në ditën e fundit, trajnimit i'u bashkëngjit edhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj, i cili së bashku me pjesëmarrësit diskutoi rreth hartimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit, duke dhënë shembuj të marrëveshjeve të mira dhe të dobëta, dhe duke diskutuar rreth shqetësimeve të përbashkëta.




Përfitues të Trajnimit ishin 15 ndërmjetësuesit e përzgjedhur për Programin Trajnues të Ndërmjetësimit.





Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve





Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660